# Operacionit "Qelqi", 5 persona të arrestuar në Tiranë (Video)

Tiranë | 12/02/2017 10:12

SHPËRNDAJE

**Policia e Tiranës ka finalizimin me sukses të operacionit "Qelqi", me ç'rast janë arrestuar në flagrancë pesë shtetas dhe janë sekuestruan rreth 30 kg lëndë e dyshuar cannabis sattiva, si dhe një armë pa leje tip "Shotgun ".**

Personat e arrestuar janë I. Z. 46 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë, F. Z. 20 vjeç, banues në Tiranë. G. B., 32 vjeç, banues në Tiranë, O. S., 24 vjeç, banues në Tiranë dhe D. A., 17 vjeç, banues në Tiranë.

Arrestimi i këtyre shtetasve u bë pasi në bashkëpunim me njëri-tjetrin dyshohen se kryenin aktivitetin e kundraligjshëm të shitjes së lëndëve narkotike të dyshuar të llojit "Cannabis Sattiva" drejt personave të ndryshëm në zonën e Kombinatit ,Yzberishtit dhe Kasharit.

Për këta shtetas kishte informacione policore se posedonin një sasi të konsiderueshme me lëndë narkotike të llojit Cannabis Sattiva dhe këtë sasi e mbanin të fshehur në banesën e shtetasit Ilir Zyberi , ku më pas do të bënin shitjen e saj.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit, Ilir Zyberi është bërë neutralizimi dhe prangosja në flagrancë e shtetasve të sipërshënuar të cilët po organizonin shitjen e lëndës së dyshuar.

Sipas Policisë, në cilësinë e provës materiale është sekuestruar: 5 (pesë) thasë me forma dhe përmasa të ndryshme me lëndë të dyshuar narkotike të llojit Cannabis Sattiva, 1 armë e llojit "SHOTGUN", 3 telefona celular, 1 palë pranga dhe 1 thikë

Materialet i'u kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për veprat penale të "Prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike në bashkëpunim dhe "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municioneve"./KosovaPress/

*Kjo web faqe mirëmbahet dhe menaxhohet nga Agjencia e Lajmeve KosovaPress. KosovaPress mban të drejtat e rezervuara me copyright sipas dispozitave ligjore për të drejtat e autorit dhe pronës intelektuale. Përdorimi, modifikimi dhe shpërndarja për qëllime komerciale pa marrëveshje me KosovaPress, ndalohet rreptësisht.*

*Të gjitha të drejtat e rezervuara nga A.P.L. KosovaPress - COPYRIGHT 2002-2019*

SHPËRNDAJE

ARTIKUJ TË SPONZORIZUAR

"Al Trade" hap pikën e re në Drenas

Magra Austria, mundësi për pushime fantastike (Foto)

## Më shumë nga KosovaPress

Policia italiane sekuestron 400 kilogramë kokainë

Gjykatat Themelore zgjedhin Avni Mehmeti për anëtar të KGjK-së

Goditi për vdekje motoçiklistin, dënohet me katër vjet e dhjetë muaj

Kryeprokurori kërkon themelimin e tri departamenteve në Prokurorinë Speciale

Kriminaliteti ka shënuar rënie në Gjilan

Gjendet një person i vdekur

Më të rejat

Kundërshtimi i Qeverisë Kurti është prioritet i opozitës së tanishme



Fëmijët më të rrezikuarit nga bota mediale

Artikuj të sponzorizuar

HerbaLife Nutrition, çelës për një jetë të shëndetshme

Bordi i drejtorëve të RIT Capital, pa vullnetin e tyre, njoftojnë për ndarjen me një nga partnerët e tyre në Ballkan

Art Motion hap pikën e re në qytetin e Mitrovicës



Kjo web faqe mirëmbahet dhe menaxhohet nga Agjencia e Lajmeve KosovaPress. KosovaPress mban të drejtat e rezervuara me copyright sipas dispozitave ligjore për të drejtat e autorit dhe pronës intelektuale. Përdorimi, modifikimi dhe shpërndarja për qëllime komerciale pa marrëveshje me KosovaPress, ndalohet rreptësisht.

Të gjitha të drejtat e rezervuara nga A.P.L. KosovaPress - COPYRIGHT
2002-2019

+383 44 507 766, +383 38 249 721 info@kosovapress.com, marketing@kosovapress.com Hamez Jashari 28 Prishtine